

BULETINI ZYRTAR

NR.2, 2007



Republika e Shqipërisë
Autoriteti i Konkurrencës

BULETINI ZYRTAR

NR.2, 2007

TIRANË, 2008



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS**

BULETINI ZYRTAR

NR.2, 2007

TIRANË, 2008



Botuar nga: Autoriteti i Konkurrencës
Përpunimi grafik: Erald Lamja
Shtypur nga: Botime Afërdita

© Autoriteti i Konkurrencës, Tiranë, 2008

Përmbajtja

- Fq.5 Vendimi nr. 53 Mbi “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 30% të aksioneve të shoqërisë Strabag SE tek shoqëria Rasperia Tranding Limited”
- Fq.8 Vendimi nr. 54 “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 76% të aksioneve në Albtelekom Sh.a tek Çetel S.A”
- Fq.12 Vendimi nr. 57 “Për “Ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Bukës në Qarkun e Fierit”;
- Fq.14 Vendimi nr. 58 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.15 Rregullore “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.26 Vendimi nr 59 “Për abuzimin me pozitën dominuese në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme të Shoqërive Albanian Mobile Communication sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.”
- Fq.43 Vendimi nr 60 “Për Hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Energjisë”
- Fq.45 Vendimi nr 61 “Për Disa Rekomandime për Tregun e Telefonisë së Lëvizshme”
- Fq.53 Vendimi Nr.62 Për njoftimin e përqendrimit “Për transferimin e 70% të kapitalit aksionar në Raiffeisen International Bank-Holding AG, zotëruar nga Raiffeisen Zentral Bank, tek shoqëria Cembra Beteiligungs GmbH”
- Fq.56 Vendimi Nr. 63 Datë 03.12. 2007, “Për vendosje gjobe ndaj Shoqërisë ProCredit Holding AG”
- Fq.58 Vendimi Nr. 64, “Mbi autorizimin e përqendrimit për përftimin e kontrollit të ProCredit Holding AG në ProCredit Bank Sh.A”.
- Fq.63 Vendimi Nr.65,, Mbi Autorizimin e përqendrimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo-Shqiptare.
- Fq.67 Vendimi Nr.66, “Për Vendosje gjobe për Shkelje të Lehtë”.
- Fq.70 Vendimi Nr. 67, “Për Vendosje sanksioni individual ndaj Z. Kajo Hallka”
- Fq.72 Vendimi Nr. 68 “Për miratimin e Udhëzuesit “Mbi Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën“

- Fq.74 Udhëzues “Për Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën”
- Fq.79 ANEKS 1, Pyetësor Për Hartuesit e Akteve Normative
- Fq.81 ANEKS 2, Shembull Vlerësimi Legjislativ
- Fq.86 Vendimi nr. 69 “Për miratimin e Kodit të Etikës të Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.88 Kodi i Etikës i Autoritetit të Konkurrencës
- Fq.93 Përmbajtja e buletineve të kaluar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 53, Datë 12.07.2007

Mbi

“Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 30% të aksioneve të shoqërisë Strabag SE tek shoqëria Rasperia Trading Limited”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12 .07 .2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimi i datës 20.Qershor 2007 “Për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 30% të aksioneve në Strabag SE nga Rasperia Trading Limited”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit,

V Ë R E N S E:

- **Rasperia Trading Limited** (sipas Marrëveshjes së Shitblerjes së Aksioneve **Blerësi**), me qendër në Limassol, Qipro, e zotëruar plotësisht nga shoqëria “Basic Element Group, me qendër në Moskë, Rusi, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në nëntor 2006 në bazë të ligjeve të Qipros dhe e regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare, me seli në Limassol, Qipro. Rasperia Trading Limited kontrollon 100% nga Zt. Oleg Deripaska, i cili është edhe pronari i shoqërisë konglomerate “Basic Element Group”.

Basic Element Group ushtron veprimtarinë e saj në tregun ndërkombëtar në 6 sektorë biznesi si: energjia, miniera-nxjerrje përpunim alumini; projektim, ndërtim e materiale ndërtimi; prodhim makinash, tregtim të artikujve të përdorimit të gjërë, shërbime financiare. **Basic Element Group nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri.**

BLR-Baubeteiliguns GmbH (sipas Marrëveshjes së Shitblerjes së Aksioneve, **Shitësi I**) është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit austriak, me seli në Vienë, Austri. BLR- Baubeteiliguns GmbH, është shitësi i 249.999 aksione, me vlerë 1 Euro secili, që përfaqësojnë 0.3571 % të kapitalit aksioner në shoqërinë Strabag SE.

BLR është pjesë e Raiffeisen Group.

- **UNIQA Versicherungeg AG** (sipas Marrëveshjes së Shitblerjes së Aksioneve, **Shitësi II**) është shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit austriak, me seli në Vienë, Austri, pjesë e grupit UNIQA GROUP, që ushtron veprimtarinë e saj në sektorët e sigurimeve të jetës dhe jo-jetës si dhe në risigurime brenda Austrisë dhe në tregun ndërkombëtar kryesisht në Evropën Qendrore dhe Lindore, si në Gjermani, Itali, Zvicër, Sllovaki, Çeki, Hungari, Poloni, Litenshteijn, Bullgari, Kroaci dhe Bosnie. UNIQA Versicherungeg AG, shitësi i 250.000 aksione, me vlerë 1 Euro secili, që përfaqësojnë 0.3571 % të kapitalit aksioner në shoqërinë Strabag SE.

UNIQA Versicherungeg AG është një bashkim i kontrolluar nga Austria Versicherungsverein auf Gegenseitigkeit Privatstiftung (35.24% të aksioneve), Raiffeisen ZentralBank Osterreich (31.95% të aksioneve), Collegialitat Versicherung auf Gegenseitigkeit (3.23% të aksioneve) dhe aksionerë të tjerë (të cilët zotërojnë 29.58% të aksioneve). UNIQA është e listuar në Bursën e Këmbimit të Aksioneve të Vienës.

UNIQA Versicherungeg AG është pjesë e UNIQA Group

- Transaksioni i realizuar nëpërmjet shitblerjes të 30% të aksioneve në Strabag SE nga Rasperia Trading Limited, përbën një përqëndrim në kuptimin e nenit 10, pika 1 shkronja a e Ligjit, si dhe përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1 të Ligjit.
 - a) **Xhiro totale në tregun ndërkombëtar** për vitin 2006 është **5712.7 miliard lekë,**
 - b) **Xhiro totale në tregun e kombëtar** për vitin 2006 është **1.0 7 miliard lekë,**

1. Tregu përkatës

a) Tregu i produktit:

Tregu i produktit është tregu i ndërtimit (ndërtimet civile dhe ndërtesa); materialet e ndërtimit (agregatet, përzierjet e asfaltit, përzierjet e gatshme të betonit); zhvillimi i projekteve.

Strabag SE është e pranishme në tregun kombëtar vetëm në ndërtimet civile, që përfshinë një shesh ndërtimi për instalimin e ujës-jellësit në Pogradec dhe nuk ka ndonjë degë apo shoqëri të rregjistruar në Shqipëri; Gjithashtu, shoqëritë respektive të grupeve të mësipërme nuk kontrollojnë asnjë shoqëri të rregjistruar sipas ligjit shqiptar „Për shoqëritë“. Pjesa e aksioneve që zotëron Strabag SE në Shqipëri është më e vogël se 5%.

b) Tregu Gjeografik: Tregu kombëtar.

Tregu gjeografik për produktin/shërbimet e ndërtimit është përcaktuar dhe pranuar tregu kombëtar (Shqipëri).

Vlerësimi i impaktit në konkurrencë

Ky transaksion nuk do të ketë ndikim negativ apo ndonjë efekt të kundërt për konkurrencën

në tregun kombëtar, sepse nuk ka treg të prekur. Strabag SE zotëron plotësisht Strabag AG që vepron në tregun shqiptar, por shërbimet e ofruara janë të ndryshme me vendet e tjera ku është e pranishme kjo kompani. Megjithëse Strabag, UNIQA dhe R-H janë në të njëjtin nivel horizontal në tregun e produktit, ato ofrojnë produkte të ndryshme dhe vetë ato apo degët e tyre në ushtrimin e veprimtarisë së tyre nuk çenojnë interesat e njëra-tjetrës. Ky arsyetim vlen edhe për Basic Element që zotëron 100% të kompanisë Rasperia Trading Limited, mbasi tregu i produktit apo tregu gjeografik për Basic Element është i kufizuar jashtë territorit të Shqipërisë.

Gjithashtu, ky transaksion nuk sjell asnjë pasojë as në nivelin vertikal. Basic Element është e integruar vertikalisht në industrinë e aluminit, përfshirë këtu që nga nxjerrja e bauksideve, përpunimi, rafinimi dhe deri në prodhimin e profileve të aluminit, por produktet përfundimtare të saj i përkasin produktit aliazh i butë që është i ndryshëm nga ai që prodhon Strabag. Ky vlerësim është në tregun ndërkombëtar, ndërsa përsa i përket tregut kombëtar Basic Element nuk është i pranishëm në Shqipëri, kështu që transaksioni nuk mund të ketë efekte në konkurrencën në treg.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit 30% të aksioneve në shoqërinë Strabag SE, si dhe përfitim të kontrollit të përbashkët së bashku me RAIFFEISEN HOLDING, UNIQA dhe HPH mbi shoqërinë STRABAG, nga shoqëria Rasperia Trading Limited, nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të Strabag AG në tregun kombëtar. Për pasojë nuk kemi kufizim të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 30% të aksioneve të shoqërisë Strabag SE nga Rasperia Trading Limited”, me qendër në Limassol, Qipro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 54 Datë 04 .09.2007

Mbi

Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 76% të aksioneve në Albtelekom Sh.a tek Çetel S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.09.2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Njoftimi i datës 25 Qershor 2007, për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 76 % të aksioneve të shoqërisë Albtelekom Sh.A tek Çetel S.A.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit,

V Ë R E N S E:

1. **Albtelekom**, shitësi i pjesës 76 % të kapitalit aksioner është shoqëri anonime me kapital 100% shtetëror, me seli në Tiranë, Shqipëri, me aksioner të vetëm METE.

Albtelekom ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit shqiptar, me një licensë shërbime publike të telekomunikacioneve për një periudhë 15-vjeçare. METE, është pronari dhe përfituesi i vetëm dhe i ligjshëm i paketës prej 11.400.00 aksione në shoqërinë “Albtelekom”, me vlerë nominale për aksion 1 000 Lekë dhe në mënyrë të tërthortë i shoqërisë Eagle Mobile. Albtelekom është operatori publik që vepron në tregun e shërbimit të telefonisë fikse, i licensuar nga ERT për ofrimin e shërbime lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për abonentët e rrjetit të tij dhe njëkohësisht ndërlidh (interkonekton) dhe mbështet operatorë të tjerë të tregut të telekomunikacionit; për ofrimin e shërbimit internet si ISP Kombëtare; si operator Backbone.

Albtelekom, ka lidhur marrëveshje interkoneksioni me operatorët mobile AMC dhe Vodafon, me operatorët për ofrimin e shërbimit të teleinformacionit (OSHT), Ofruesit të Shërbimit me kartë të parapaguar (OSHKP).

Eagle Mobil, filial i Albtelekom, shoqëri aksionare, e zotëruar plotësisht (100%) nga Albtelekom, e themeluar nga Albtelekom, e rregjistruar në bazë të Vendimit Nr 30436, datë 24 Tetor 2003, të Gjykatës Tiranës dhe e licensuar në bazë të licensës Nr 253/03/04 datë 1 Mars 2004, për të ofruar shërbim publik të lëvizshëm, tokësor, sipas standartit GSM. Licensa e shoqërisë “Eagle Mobile” është shtyrë 3 herë me një 12 muaj dhe licensa aktuale përfundon në Mars 2008.

2. **ÇETEL A.S,** është aksioneri/blerësi i pjesës 76 % të kapitalit të paketës së vetme të përbërë nga 11.400.000 aksione në Albtelekom, me vlerë nominale për aksion 1000 Lekë, përfaqësuar nga zt. Ahmet Çalik.

ÇETEL është shoqëri anonime e themeluar dhe e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, pjesë e grupit Çalik Holding.

Çalik Holding është i pranishëm në tregun bankar shqiptar, si aksionar/ zotëruar i pjesës 60% të kapitalit aksionar në Bankën Kombëtare Tregtare, nëpërmjet. Çalik Seker.

ÇETEL A.S nuk ka veprimtari ekonomike në Shqipëri. ÇETEL ka nënshkruar marrëveshje ortakërie dhe menaxhimi me shoqërinë Turk Telekomunikation.

Turk Telekomunikation A.S e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, me qendër në Ankara, Turqi, ushtron veprimtari në fushën e telekomunikacionit si për ofrimin e shërbimit me shumicë dhe pakicë zanor. Turk Telekomunikation A.S do të asistojë ÇETEL përse i përket manaxhimit të Albtelekomit për kryerjen e shërbimeve të telefonisë fikse dhe GSM, manaxhimit dhe vënies në funksionim të infrastrukturës së telomunikacionit për të gjitha segmentet e linjës fikse/tokësore në tregun kombëtar.

3. Për vitin 2006, xhiro e palëve pjesëmarrëse në transaksion është:
 - në tregun ndërkombëtar xhiro totale Çalik Group është 103.946 miliard lekë, nga ku:
 - **Çalik Holding** **99.002 miliard lekë**
 - **Çalik Seker** **4.944 miliard lekë**
 - **ÇETEL S.A** **0 USD / 0 lekë**
 - në tregun kombëtar e Albtelekom Sh .A është 11.424 miliard Lekë.

Transaksioni i realizuar nëpërmjet shitblerjes të paketës 76% të aksioneve nga Çetel S.A, përbën një përqëndrim në kuptimin e nenit 10, pika 1 shkronja a e Ligjit, si dhe përmbush

kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1 të Ligjit.

4. Tregu përkatës

a) Tregu i produktit:

- **Në tregun e telekomunikacionit:**

- Shërbimi telefonik automatik,
- Shërbimi internet,
- Shërbimi telegrafik,
- Shërbimi i ISDN,
- Shërbimi me kartë të parapaguar,
- Interkoneksioni,
- Dhënia me qera të tretëve, e qarqeve dhe linjave telefonike,
- Shërbime që realizohen përmes postës,
- Mirëmbajtja dhe mirëfunksionimi i linjës telefonike të abonentit, dhe

Në tregun e telefonisë fikse Albtelecom zotëron rreth 88% të tij, të përcaktuar sipas numrit total të abonentëve prej 259.637, nga të cilët 35000 janë abonentë ruralë dhe vlerës së shitjes që për vitin 2006 është 3.890.679.000. E ardhura nga shitjet për njësi (e ardhura mesatare mujore për abonent është 1.288 lekë /për abonent. Rreth 12% e tregut sipas abonentëve zotërohet nga 49 operatorë ruralë të licensuar nga ERT.

Operatori “Eagle Mobile” është licensuar si operatori i tretë kombëtar i shërbimit celular GSM në Shqipëri më 1 Mars 2004. Ky operator ende nuk është aktiv në treg. Me vendim të ERT, afati i fillimit të operimit të rrjetit është shtyrë deri më Mars 2008. Si rezultat i investimeve të parashikuara, rritjes së numrit të abonentëve, uljes së tarifave të parashikuara nga Blerësi, konkurrenca në këtë treg pritet të rritet.

Në tregun e shërbimeve për ofrim interneti, ADSL dhe modem, Albtelekom zotëron 25%. Theksojmë se tregu i shërbimeve të ofrimit të internetit është shumë konkurrues.

- **Në tregun bankar** (ofrimi i shërbimeve bankare)

Shoqëria Çalik Holding(e cila ka te shoqëria 80 % të aksioneve të CETEL) në tregun bankar shqiptar përfaqësohet me Bankën Kombëtare ku zotëron 60 % të aksioneve. Kjo bankë zotëron 13.03% sa i përket aktiveve të sistemit bankar, 11.06 % të kredive, 13.55 % të tregut të bonove të thesarit dhe 16.50 % të totalit të depozitave.

b) Tregu Gjeografik: Tregu kombëtar.

Shoqëria Albtelekom Sh.a operon me seli qendrore në Tiranë dhe të ndarë në 13 rajone që mbulojnë 25 zona në të gjithë territorin.

Banka Kombëtare tregtare shtrihet nëpërmjet degëve të saj në 16 qytetet më kryesore të Shqipërisë.

Megjithëse palët pjesëmarrëse në përqëndrim ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel tregu të ofrimit të shërbimit, në tregun kombëtar, por duke qenë se shërbimet i përkasin tregjeve të ndryshme (financiar dhe telekomunikacion) nuk kemi të bëjmë me tregje të prekura;

po për këtë arsye palët pjesëmarrëse në përqëndrim nuk janë të integruara vertikalisht dhe horizontalisht në tregun e ofrimit të shërbimit.

Në tregun e shërbimeve për ofrim interneti, ADSL dhe modem, Albtelekom do të monitorohet për sjelljen në tregun e shumicës (wholesale).

Ndërsa në tregun e shërbimit me pakicë (të përdoruesit të internetit) Albtelekom zotëron 25% dhe ky treg është i hapur për konkurrencë si pasojë e numrit të licensave të dhëna dhe penetrimit të ulët të shërbimit të internetit në tregun shqiptar.

Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë në vazhdimësi tregun e telekomunikacioneve në dy drejtime: të strukturës, mbasi raporti i përqendrimit të tregut të telefonisë fikse është shumë i lartë, si dhe të sjelljes të ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg për të shmangur abuzimet e mundshme me pozitën dominuese apo praktikatat e bashkërenduara që çënojnë konkurrencën, ndërmjet operatorëve aktualë dhe atyre potencialë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të 76% të kapitalit aksionar në Albtelekom nga ÇETEL, dhe nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të shoqërisë së re pas përqendrimit.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 76 % të kapitalit aksionar të Albtelekom Sh.A tek Çetel S.A, me qendër në Stamboll, Turqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)

Zv/Kryetar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 57 , Datë 01. 10. 2007

Për

**“Ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Bukës
në Qarkun e Fierit”**

Në zbatim të nenit 24, shkronja d, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 01.10.2007, shqyrtoi Raportin e Grupit të Punës për përfundimin e procedurës së Hetimit Paraprak, të hapur me Vendimin Nr. 455, datë 29.08.2007 të Sekretarit të Përgjithshëm dhe rezultatet e inspektimeve të kryera, prej nga:

K O N S T A T O I:

1. Ndërmarrjet nën hetim, “Marlen” sh.p.k, “Basha” sh.p.k, “Apollonia B” shpk, “Fatri Zijaj”, “Vladimir Resuli”, “Lavdiqe Ramaj” (Patos), “Genci Numanaj”(Patos), “Sokol Malaj” (Ballsh), “Ylber Shameti” (Ballsh), “Valter Veizi” (Ballsh), me datë 08.08.2007, kanë nënshkruar një marrëveshje që bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sepse:
 1. Fikson çmimet e shitjes së bukës masive në 100 Lekë;
 2. Rrit çmimet e llojeve të tjera të bukës me rreth 17%.
2. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi që me datë 16.08.2007 dhe përbën shkelje të rëndë të konkurrencës pasi grupimi i ndërmarrjeve eliminon konkurrencën mes tyre duke fiksuar çmimin e shitjes që bie ndesh me nenin 4/a të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe përbën shkelje të rëndë sipas nenit 74, pika 1, germa a të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, dhe nenin 45 të ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 61 të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S I:

1. Ndalimin e Marrëveshjes së lidhur më datë 08.08.2007 ndërmjet ndërrmarjeve prodhuese të bukës në Qarkun e Fierit, më konkretisht midis: “Marlen” Sh.p.k, “Basha” Sh.p.k, “Apollonia B”, “Fatri Zijaj”, “Vladimir Resuli”, “Lavdije Ramaj” (Patos), “Genci Numanaj” (Patos), “Sokol Malaj” (Ballsh), “Ylber Shameti” (Ballsh), “Valter Veizi” (Ballsh), si marrëveshje e ndaluar në bazë të nenit 4, pika 1, germa a të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për vazhdimin e hetimit për të përcaktuar pasojat e veprimit antikonkurrues dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.
3. Afati i mbylljes së procedurave dhe marrja e vendimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës do të jetë brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 01.10. 2007

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 58 Datë 15.10.2007

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

në mbledhjen e tij të datës 15 .10 .2007, në mbështetje të nenit 24, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të tij,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

(_____)

Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Rregullore

“Për Funkzionimin e Autoritetit të Konkurrencës

Mbështetur në Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (në vijim: Ligji) dhe në veçanti në zbatim të nenit 24, shkronja c) dhe 84, shkronja a) të këtij ligji, Komisioni i Konkurrencës miraton rregulloren “Për Funkzionimin e Autoritetit të Konkurrencës”

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave të funksionimit të punës në Autoritetin e Konkurrencës, si dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në përmbushje të detyrimeve ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Neni 3

Drejtimit e Përgjithshme të punës së Autoritetit të Konkurrencës

1. Autoriteti i Konkurrencës ushtron veprimtarinë e tij si një institucion publik, i pavarur në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si dhe për krijimin e një kulture të konkurrencës në mjedisin shqiptar, nëpërmjet hartimit të politikës kombëtare të konkurrencës dhe kontrollit të zbatimit të legjislacionit të konkurrencës.
2. Autoriteti i Konkurrencës për ushtrimin e veprimtarisë së tij në zbatim të Ligjit si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, bashkëpunon me Komisionet Parlamentare, me institucionet e administratës qendrore dhe vendore, institucionet e tjera publike si dhe palët e tjera të interesuara.
3. Autoriteti i Konkurrencës harton dhe zbaton buxhetin e tij, sipas akteve ligjore në fuqi, duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Financës dhe Kuvendin e Shqipërisë.
4. Autoriteti i Konkurrencës synon vendosjen e lidhjeve reciprociteti dypalësh dhe shumëpalësh, në nivel rajonal dhe global si dhe mban lidhje me organizmat ndërkombëtare, merr pjesë në veprimtari të ndryshme që organizohen brenda e jashtë vendit, në bashkëpunim me këto institucione, duke respektuar marrëveshjet e përbashkëta dhe legjislacionin në fuqi.

5. Autoriteti i Konkurrencës siguron plotësimin e kuadrit ligjor për konkurrencën, nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore, si rregullore dhe udhëzime. Autoriteti i Konkurrencës synon përafrimin e legjislacionit vendas me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e konkurrencës.
6. Për të siguruar mbarëvajtjen e punës së Autoritetit, si dhe përgjegjësinë e korrektesën në marrjen dhe zbatimin veprimeve, Komisioni dhe Sekretariati, në kryerjen e detyrave të tyre, udhëhiqen nga Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar) dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu Sekretariati i Konkurrencës zbaton dispozitat e Ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", Ligjit nr 9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike", dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 4

Struktura dhe organizimi

1. Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës, dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor.
2. Struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës miratohet nga Kuvendi bazuar në Ligjin nr. 9584 Datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese, si dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj".

Neni 5

Kompetencat e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit

1. Komisioni i Konkurrencës ushtron veprimtarinë e tij vendimmarrëse si organ kolegjal. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë përcaktuar në nenin 24 të Ligjit.
2. Komisioni i Konkurrencës drejtohet nga një Kryetar, i cili emërohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komisionit janë përcaktuar në nenin 25 të Ligjit.
3. Kryetari është drejtuesi ekzekutiv i punës së përditshme të Autoritetit të Konkurrencës dhe drejton mbledhjen e Komisionit, drejton diskutimet, dhe siguron zbatimin e ligjit.
4. Kryetari është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjitha çështjeve që paraqiten për shqyrtim pranë Komisionit të Konkurrencës, si dhe për mbarëvajtjen e përgjithshme të punës së Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 6

Mungesa dhe pamundësia për të ushtruar kompetencat

1. Në rast se Kryetari i Komisionit mungon apo është në pamundësi fizike për të ushtruar kompetencat në drejtimin e Komisionit, Zëvendëskryetari merr dhe ushtron këto kompetenca në përputhje me nenin 25 të Ligjit.
2. Në rast se Kryetari dhe Zëvendëskryetari mungojnë apo janë në pamundësi fizike për të ushtruar kompetencat njëri nga anëtarët e Komisionit merr dhe ushtron kompetencat për mbarëvajtjen e përgjithshme të punës së Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 7

Marrëdhëniet e tjera me publikun

Qëndrimet publike të Kryetarit, Zëvendëskryetarit, anëtarëve të Komisionit dhe punonjësve të Autoritetit për çështjet konkrete në shqyrtim, si rregull, konsultohen edhe/ ose diskutohen paraprakisht në Komisionin e Konkurrencës.

Neni 8

Mbledhjet e radhës

1. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur Komisioni ka vendosur ndryshe. Në rast nevojë, ai mund të thërrasë dhe mbledhje të jashtëzakonshme.
2. Anëtarët e Komisionit njoftohen menjëherë për çdo ndryshim për datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet, si dhe për mbledhjet e jashtëzakonshme të thirrura nga Kryetari.
3. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një argumentim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes

Neni 9

Thirrja e mbledhjeve

1. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1(një) anëtar i Komisionit, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Si objekt i mbledhjes konsiderohen çështje për të cilat Komisioni është i mandatuar sipas Ligjit.
2. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 7(shtatë) ditëve pune pas paraqitjes së kërkesës nga 1(një) anëtar i Komisionit dhe, të paktën 3(tre) ditëve pune para datës së thirrjes së mbledhjes.
3. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

Neni 10

Pjesëmarrja në mbledhjet e Komisionit

1. Në mbledhjet e Komisionit mund të marrin pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm, i shoqëruar nga Drejtori i drejtorisë përkatëse të Sekretariatit si dhe, në rast nevojë, specialistë të tjerë të Sekretariatit apo ekspert të jashtëm, që kanë qenë të angazhuar me trajtimin e çështjeve në shqyrtim. Pjesëmarrja e specialistëve të Sekretariatit dhe ekspertëve të jashtëm në mbledhje bëhet me miratimin e Komisionit.
2. Si rregull, mbledhjet e komisionit janë të mbyllura për publikun por në raste të veçanta me propozimin e kryetarit/anëtarit dhe me miratimin e Komisionit mbledhjet mund të bëhen të hapura për median dhe publikun.

Neni 11

Rendi i ditës

1. Kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë paraqitur Komisionit për shqyrtim nga Sekretariati, si dhe që i janë propozuar atij nga anëtarët e Komisionit. Kërkesa e anëtarëve të Komisionit për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3(tre) ditë pune para datës së vendosur për mbledhjen.
2. Rendi i ditës duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 7(shtatë) ditë pune përpara datës së mbledhjes. Si rregull, raportet hetimore, të përgatitura nga Sekretariati, duhet t'u vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve të Komisionit, të paktën 7(shtatë) ditë pune përpara zhvillimit të mbledhjes.

Neni 12

Marrja e vendimeve

1. Komisioni merr vendime vetëm për çështje që janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur shumica e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Komisioni merr vendim për të ndërmarrë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë në zbatim të nenit 41 të Ligjit.
3. Komisioni merr vendim për fillimin e një procedure paraprake të hetimit në zbatim të nenit 42 të Ligjit.
4. Vendimet për rastet e parashikuara në paragrafin 2 dhe 3 mund të merren edhe me propozimin e një anëtari të Komisionit.
5. Komisioni në bazë të raportit të paraqitur nga sekretariati vendos miratimin ose refuzimin e hapjes së procedurës së hetimit të thelluar.
6. Në çdo rast, marrja e vendimeve bëhet duke respektuar procedurat e nenit 26 të Ligjit.

Neni 13

Thirrja e mbledhjeve jashtë procedurës së zakonshme

Mbledhja e Komisionit, përveç procedurave të zakonshme, është e vlefshme edhe në raste të tjera, por me kusht që në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit, të cilët, paraprakisht, bien dakord për zhvillimin e saj dhe miratojnë rendin përkatës të ditës.

Neni 14

Seanca dëgjimore

1. Komisioni mund të zhvillojë në çdo moment të procedurës, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, seanca dëgjimore, ku palëve në proces u jepet mundësia për

të bërë të njohur këndvështrimet e tyre me shkrim dhe/ose me gojë.

2. Me kërkesë të palëve të interesuara, Komisioni i Konkurrencës mund të zhvillojë seanca dëgjimore në çdo moment të procedurës, ku palëve iu sigurohet mundësia e dëgjimit nga Komisioni Konkurrencës
3. Në seancat dëgjimore, Komisioni mund të ftojë edhe palë të treta ose ekspertë të angazhuar për çështjet që trajtohen.
4. Si rregull, seancat dëgjimore janë të mbyllura për publikun. Pala që dëgjohet mund të kërkojë paraprakisht përjashtimin në dëgjim të palës/palëve të tjera, të ekspertëve të ngarkuar me çështjen.
5. Komisioni vendos rast pas rasti nëse mbledhjet do të jenë të hapura ose jo.

Neni 15

Detyrat e Kabinetit pranë Komisionit

Kabineti pranë Komisionit, ka këto detyra:

- Organizon mbledhjet e Komisionit;
- Mban marrëdhënie me mas-mediat;
- Nxjerr deklarata për shtyp në lidhje me veprimtaritë zyrtare të Autoritetit, dhe
- Organizon veprimtaritë e jashtme.

Neni 16

Organizimi i mbledhjeve të Komisionit dhe Seancave Dëgjimore

1. Mbledhjet e Komisionit dhe seancat dëgjimore organizohen nga Kabineti, i cili është përgjegjës për shpërndarjen e materialeve përkatëse në bashkëpunim me sekretariatit tek të gjithë anëtarët e Komisionit, brenda afateve kohore të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Kabineti kujdeset për respektimin e afateve në paraqitjen e raporteve hetimore, kërkesave apo materialeve të tjera për t'u shqyrtuar nga Komisioni. Për këtë ai bashkëpunon ngushtë me Sekretariatit.
3. Kabineti është përgjegjës për respektimin e afateve për njoftimin e palëve në proces, palëve të treta, apo ekspertëve, të cilët kërkojnë ose ftohen të marrin pjesë në seancat dëgjimore. Për këtë ai bashkëpunon ngushtë me Sekretariatit.
4. Kabineti siguron mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes, i cili, pasi zbardhet, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm dhe protokollohet në regjistrin e Komisionit.
5. Si rregull, në fund të çdo mbledhje të Komisionit, Kabineti nxjerr njoftimin për mediat.

Neni 17

Kompetencat e Sekretariatit

1. Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm.
2. Përgjegjësitë e Sekretariatit janë përcaktuar në nenin 28 të ligjit. Ai kryen detyrat e tij në përputhje me ligjin dhe në mënyrë të pavarur, me përjashtim të rasteve që janë kompetencë e Komisionit.
3. Sekretariati gjithashtu, harton dhe paraqet për miratim në Komisionin e Konkurrencës projekt-rregulloret që lidhen me fushën e veprimtarisë së tij, si dhe projekt-udhëzimet dhe projekt-akte të tjera që lidhen me zbatimin e ligjit, brenda afateve kohore që përcakton Komisioni i Konkurrencës.

Neni 18

Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm janë përcaktuar në nenin 29 të Ligjit.
2. Sekretari i Përgjithshëm nënshkruan të gjitha vendimet procedurale të marra në emër të Sekretariatit.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin e punëve të Sekretariatit. Ai në veçanti koordinon punën e Drejtorive dhe të sektorit në varësi të tij, me synim rritjen e efikasitetit të punës së Sekretariatit.

Neni 19

Struktura e Sekretariatit, Objektivat dhe Përgjegjësitë

1. Në mbështetje të Ligjit dhe të Vendimit të Kuvendit nr 96, datë 30.04.2007 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Konkurrencës” Sekretariati përbëhet nga tre drejtori dhe një sektor. Organigrama e Autoritetit të Konkurrencës përbën Aneksin 1 të kësaj rregulloreje.
2. Misioni i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut është monitorimi, studimi dhe hetimi i kushteve të tregut për praktikatat që pengojnë, shtrembërojnë ose kufizojnë konkurrencën në treg, sipas përcaktimeve të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Drejtoria është ndarë në tre sektorë sipas kolonave kryesore të ligjit, sektori i Abuzimit me Pozitën Dominuese, Sektori Anti-Kartel dhe Sektori i Përqendrimeve.

- Sektori i Abuzimit me Pozitën Dominuese është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjit për ndërmarrjet me fuqi të ndjeshme në treg dhe ndjek me vëmendje abuzimet e mundshme me pozitën dominuese të një ose disa ndërmarrjeve në treg.
- Sektori anti-kartel ose i marrëveshjeve të ndaluara që në përcaktimin e ligjit do të shqyrtojë të gjitha praktikatat e Marrëveshjeve të ndaluara që fiksojnë çmimet, kufizojnë ofertën, ndajnë tregjet ose pengojnë hyrjet e reja në treg.

- Sektori i Përqendrimeve do të shqyrtojë praktikat e përqendrimeve lidhur me përfitimin e kontrollit, bashkimit të ndërmarrjeve ose krijimit të një shoqërie të re. Sektori do të ndjekë me vëmendje rastet e krijimit apo fuqizimit të pozitës dominuese duke propozuar ndalimin e tyre.
3. Drejtoria Juridike dhe e Integritimit përbëhet nga dy sektorë dhe ka objektiva kryesore:
- Vlerësimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me përputhshmërinë me Ligjin dhe shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës. duke synuar përfrimin e legjislacionit vendas me “Acquis Communautaire”. Vlerësimi i përputhshmërisë së projekt-akteve normative të propozuara nga institucionet e tjera qendrore dhe vendore në fushën e konkurrencës.
 - Zbatimin e politikave ekzistuese si dhe përshtatjen e politikave të reja në fushën e hartimit të legjislacionit në sferën e konkurrencës.
 - Ndjekjen e procedurave të proceseve gjyqësore dhe hartimin e materialeve juridike të këtyre procedurave, në të cilat Autoriteti i Konkurrencës është palë ndërgjyqës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të institucionit.
 - Dhënien e ndihmës së nevojshme profesionale, në bashkëpunim me Kabinetin, për hartimin dhe redaktimin e akteve juridike të Autoritetit dhe Komisionit në veçanti, sa here që i kërkohet nga ky i fundit.
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit. përbëhet nga dy sektorë dhe ka objektiva kryesore:
- Menaxhim efektiv të burimeve njerëzore, organizimin për kualifikim dhe trajnim të punonjësve në përputhje me Ligjin Nr 8549, datë 11.11.1999, “Për Shërbimin Civil”,
 - Monitoron zbatimin e të gjitha politikave të personelit që përmbledhin plotësimin e kërkesave, vlerësimin dhe klasifikimin e punëve, rekrutimin dhe seleksionimin, vlerësimin e rezultateve në punë, pagesën trajnimin dhe zhvillimin individual, disiplinën dhe procedurat e marrëdhënieve midis nëpunësve për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të tyre në të gjithë institucionin.
 - Zhvillon, këshillon dhe koordinon aplikimin e konsulencës dhe strategjive të komunikimit të hartuara për të inkurajuar angazhimin e stafit, kryerjen e detyrave dhe minimizimin e konflikteve.
 - Monitoron përdorimin efikas të vlerave financiare dhe materiale.
5. Sektori i Studimeve dhe Analizës ka objektiv kryesor monitorimin dhe analizimin e kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në Shqipëri.
6. Drejtorët e Drejtorive drejtojnë punën në fushat që mbulojnë. Drejtorët e Drejtorive raportojnë rregullisht tek Sekretari i Përgjithshëm për mbarëvajtjen e punës.
7. Drejtorët e Drejtorive janë përgjegjës për organizimin e punëve në Drejtoritë e tyre, si dhe për shfrytëzimin efikas të burimeve njerëzore nën drejtimin e tyre. Ata informojnë punonjësit në varësi të tyre për të gjitha objektivat e punës dhe për të gjitha çështjet e rëndësishme për administrimin e drejtorisë, bëjnë ndarjen e detyrave dhe kontrollojnë realizimin e tyre.

8. Drejtorët e Drejtorive miratojnë lejet brenda një dite, të punonjësve të tyre, për arsye personale.

Neni 20

Informimi dhe mënyra e raportimit

1. Sekretari informon me shkrim dhe raporton në Komision sipas kërkesës së këtij të fundit.
2. Informimi dhe raportimi ndërtohet mbi bazën e hierarkisë.

Neni 21

Përgjegjësitë e Sekretariatit në procedurat hetimore

1. Sekretariati informon me shkrim menjëherë Komisionin në rastet kur hap procedurën e hetimit paraprak me nismën e tij, me kërkesën e ndërmarrjeve të interesuara ose në bazë të një ankese të të tretëve. Hetimi paraprak synon konstatimin e një kufizimi të mundshëm të konkurrencës.
2. Në rastet kur mendohet se mund të komprometohet procedura hetimore, të bëhet e pamundur mbledhja e provave nga inspektimet në zbatim të neneve 36 dhe 37 të ligjit, Sekretariati nuk është i detyruar të komunikojë fillimin e procedurës paraprake të hetimit.
3. Ndërmarrjet që hetohen ose palë të tjera të interesuara nuk kanë të drejtë të konsultojnë dosjet në fazën e procedurës paraprake të hetimit.
4. Sekretariati në përfundim të procedurës paraprake të hetimit përgatit dhe i paraqet Komisionit raportin e argumentuar, duke i kërkuar këtij të fundit marrjen e vendimit për hapjen e hetimit të thelluar në zbatim të nenit 43 të Ligjit. Në këtë rast zbatohet neni 12 i kësaj rregulloreje.
5. Sekretariati në përfundim të procedurës hetimore, bazuar në faktet dhe analizat e kryera, përgatit dhe i paraqet Komisionit raportin përfundimtar me sugjerimet përkatëse. Në këtë rast zbatohet neni 12 i kësaj rregulloreje.
6. Sekretariati zbaton vendimet e Komisionit

Neni 22

Grupet e punës

1. Për trajtimin e çështjeve që mbulohen nga më shumë se një drejtori dhe janë objekt i punës së Sekretariatit, krijohen grupe pune, të cilat përbëhen nga punonjës të drejtorive të ndryshme. Çdo grup pune ka një drejtues.
2. Anëtarët e grupit të punës propozohen nga drejtorët e drejtorive. Përbërja e grupit miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm cakton edhe drejtuesin e grupit të punës.
3. Drejtuesi i grupit të punës raporton tek Sekretari i Përgjithshëm për mbarëvajtjen e punës së grupit. Me krijimin e grupit të punës, përcaktohet objektivi, si dhe një matricë me detyrat dhe afatet konkrete për realizimin e tij.

Neni 23

Kontrolli i veprimtarisë së brendshme

1. Për të kontrolluar veprimtarinë e brendshme të Autoritetit, Komisioni vendos ngritjen e një grupi të përkohshëm pune.
2. Anëtarët e grupit të punës kanë të drejtë të konsultojnë, brenda mandatit të tyre kontrollues, të gjithë dokumentacionin që lidhet me objektin e kontrollit.
3. Në përfundim të kontrollit, grupi i punës i paraqet Komisionit një raport të hollësishëm mbi kontrollin e ushruar, si dhe bën rekomandimet përkatëse.

Neni 24

Regjistrimi i dokumenteve

1. Në Autoritetin e Konkurrencës mbahet një regjistër i përgjithshëm për regjistrimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e korrespondencës, në nisje dhe në mbërritje, në përputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”
2. Lëvizja e korrespondencës kryhet mbi bazën e hierarkisë administrative.
3. Korrespondenca për nisje duhet të dërgohet në origjinal në zyrën e arshivës, e cila, pasi regjistron në regjistër dokumentin në nisje, konfirmon shpërndarjen, duke e dërguar materialin për nisje në njësinë e postës.
4. Korrespondenca e regjistruar vendoset në dosje dhe arkivohet në Arkivin e Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 25

Regjistrimi i njoftimeve

1. Në Autoritetin e Konkurrencës mbahet një regjistër i veçantë për regjistrimin e njoftimeve të përqendrimeve. Mbajtja e këtij regjistri, në formë të shkruar dhe elektronike, është nën përgjegjësinë e Sektorit të Përqendrimeve dhe mbikëqyret nga Drejtori që mbulon këtë sektor.
2. Sekretariati i jep palës njoftuese një vërtetim për marrjen në dorëzim të njoftimit duke përcaktuar me saktësi numrin e regjistrimit dhe datën e marrjes në dorëzim të njoftimit dhe dokumentacionit bashkëlidhur.
3. Sekretariati informon me shkrim Komisionin për datën e saktë të dorëzimit të njoftimit dhe të dokumenteve bashkëlidhur, si dhe formën e njoftimit të plotësuar nga palët pjesëmarrëse në një përqendrim.
4. Sekretariati, për vlerësimin e përqendrimeve, zbaton Rregulloren “Për Zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”

Neni 26

Konfidencialiteti

Për ruajtjen e sekretit si dhe konfidencialitetit të të gjitha materialeve të korrespondencës, të gjithë punonjësit e Autoritetit të Konkurrencës veprojnë në përputhje me nenin 30 të ligjit, Kodin e Procedurave Administrative, Rregulloren e Etikës së Autoritetit të Konkurrencës dhe akte të tjera ligjore në fuqi.

Neni 27

Ndryshimet në Rregullore


Ndryshimet në Rregulloren “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës bëhen me propozim të 1(një) apo më shumë anëtarëve të Komisionit ose të Sekretariatit.

1. Ndryshimet në Rregullore miratohen nga Komisioni sipas Ligjit.
2. Ndryshimet e propozuara së bashku me relacionin përkatës si rregull depozitohen paraprakisht për një periudhë prej 15 ditësh përpara shqyrtimit në Komision.

Neni 28

Hyrja në fuqi

- Rregullorja “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me Vendimin nr. 2, date 17.03.2004 të Komisionit të Konkurrencës shfuqizohet.
- Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M

Nr.59, datë 09.11.2007

Për

**“Abuzim me pozitën dominuese në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme të Shoqërive
 Albanian Mobile Communication sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.11.2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e abuzimit me pozitën dominuese të shoqërive Albania Mobile Communication sh.a dhe Vodafone Albania sh.a në tregun e telefonisë së lëvizshme, ose shkelje të tjera të konkurrencës në këtë treg.

Baza ligjore:

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 8, neni 9, neni 24 germa d, neni 74 pika 1, shkronja a dhe neni 75 pika 1.
- Kodi i Procedurave Administrative

Palët nën hetim:

- Albanian Mobile Communication sh.a (AMC) me seli në Rr.”Gjergj Legisi” Laprakë, Tiranë,
- Vodafone Albania sh.a. me seli në European Trade Center Blv.”Bajram Curri” Kt.11, Tiranë (tani e në vijim në formë të shkurtuar AMC dhe Vodafone).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës “Për hetimin e Thelluar në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme”,
- Parashtrimeve të palëve në Seancat Dëgjimore përkatëse: të datave 07.06.2007 me AMC-në; dhe 13.06.2007 me Vodafone.

VËREN SE:

I. Fusha e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

1. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës zbatohet për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg dhe që e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 2 i Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës). AMC dhe Vodafone ofrojnë shërbime të telefonisë së lëvizshme në territorin e Shqipërisë dhe konsiderohen si ndërmarrje në bazë të nenit 3 pika 1 të këtij ligji. Si rrjedhim, veprimtaria e këtyre dy ndërmarrjeve përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

II. Çështja në shqyrtim

2. Hetimi i thelluar i adresohet shërbimit publik të telefonisë së lëvizshme të ofruar nga dy kompanitë celulare AMC dhe Vodafone.
3. Tregu i telefonisë celulare u hap në Maj të vitit 1996 me licencimin e kompanisë AMC (licensa nr.1) dhe fillimin e aktivitetit të saj. Në 25.07. 2000, Telenor - Cosmote bleu 85 % të aksioneve të AMC-së, pjesa tjetër prej 12.6% të aksioneve zotërohen nga Shteti Shqiptar të administruara nga Ministria e Ekonomisë, e Tregtisë dhe Energjetikes së Shqipërisë dhe 2.4% zotërohen nga aksionerët e vegjël, punonjës të AMC-s ne kohën e privatizimit.
4. Më 9 qershor 2001, Vodafone, licencohet si operator i dytë i shërbimit celular në Shqipëri (licensa nr.2), me kapital të përbashkët të Vodafone International Holding (51% të aksioneve) dhe Panafone International Holding (49 % të aksioneve).
5. Më 1 mars të vitit 2004 u licencua operatori i tretë, Eagle Mobile (licensa nr 3) me 100% të aksioneve në zotërim të Albtelekom sh.a. Ky operator nuk ka patur veprimtari në treg gjatë gjithë periudhës së hetimit.
6. Në këto kushte në tregun e telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës së hetimit kanë vepruar vetëm dy operatorë, shoqëritë nën hetim, AMC dhe Vodafone .

III. Periudha e hetimit

7. Hetimi në Tregun e telefonisë së lëvizshme përfshin vitet 2004 dhe 2005.
8. Për të parë sjelljen në një periudhë më të gjatë kohe të shoqërive objekt hetimi, Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar tregun e telefonisë së lëvizshme nga viti 1996 deri në vitin 2005.

IV. Procedurat e ndjekura gjatë hetimit

9. Procedurat e ndjekura gjatë hetimit janë bazuar në kreun III të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës“ dhe Kodin e Procedurave Administrative.

10. Me nismën e tij, Autoriteti i Konkurrencës filloi në Shtator të vitit 2005 një hetim në Sektorin e Telefonisë së Lëvizshme. Shkak për fillimin e këtij hetimi u bënë shqetësimi i opinionit publik për çmime të larta në Tregun e Telefonisë Celulare, i prononcuar në median e shkruar dhe elektronike, kryesisht nga shoqatat dhe institucionet përfaqësuese të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve (Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Avokati i Popullit, etj.) Ky shqetësim është bërë evident në Rekomandimet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU).¹
11. Komisioni i Konkurrencës, pasi administroi dhe shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga Sekretariati dhe pretendimet e dy operatorëve në këtë treg, AMC dhe Vodafone, gjykoj se mund të kishte kufizime të konkurrencës në këtë treg.
12. Me Vendimin e tij nr. 21, date 11.10.2005 Komisioni vendosi “Për nisjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme në përgjithësi dhe veçanërisht në shoqëritë AMC sh.a dhe Vodafone Sh.a, përsa i përket ekzistencës ose jo të abuzimit me pozitën dominuese ose shkelje të tjera të konkurrencës në këtë treg”
13. Në bazë të vendimit nr. 21, date 11.10.2005 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me ligjin nr 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës “Raportin e Hetimit të Thelluar”. Në bazë të nenit 47 të K.Pr.A., shoqërive nën hetim, AMC dhe Vodafone u janë vënë në dispozicion raporte të veçanta duke hequr nga raporti përfundimtar të dhënat konfidenciale të palëve.
14. Në zbatim të nenit 39, të ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, palët kanë dhënë pretendimet e tyre mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në seancat dëgjimore të mbajtura, përkatësisht më 7 qershor 2007 për AMC dhe më 13 qershor 2007 për Vodafone.

V. Tregu përkatës

15. Në bazë të nenit 3, pika 7 të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.

V.A. Tregu përkatës i produktit

16. Tregu përkatës i produktit është shërbimi publik i telefonisë së lëvizshme, që ofrojnë secila nga të dy kompanitë celulare AMC dhe Vodafone, ose transmetimi i thirrjeve telefonike që ato kryejnë për përdoruesin fundor të tyre (të gjeneruar nga ky përdorues, apo me destinacion këtë përdorues).
17. Në këtë përcaktim është pasur në konsideratë shërbimi i telefonisë së lëvizshme, vetëm në kuptimin e thirrjeve zanore.

¹ ERT të nisë një inspektim të marrëveshjes së interkoneksionit ndërmjet Albtelekomit nga njëra anë dhe AMC dhe Vodafon nga ana tjetër, pasi këto marrëveshje në formën aktuale dhunojnë Aktin e Telekomunikacionit dhe dëmtojnë interesat publike”

18. Telefonia fikse, nuk mund të përfshihet në këtë treg për arsye të veçorive të ndryshme që ajo ka, në raport me telefoninë e lëvizshme. Nga pikëpamja e konsumatorëve, shërbimet e telefonisë fikse nuk janë të zëvendësueshme me shërbimet e telefonisë së lëvizshme, pra tregu i telefonisë së lëvizshme përbën një treg të ndarë nga tregu i telefonisë fikse
19. Përdoruesi i telefonisë së lëvizshme ka mundësi ta ketë këtë shërbim gjithmonë me vete² (nëpërmjet një aparati telefonik celular) dhe disponibël për ta përdorur në çdo vend, të paktën brenda territorit të shërbimit që mbulon operatori, ku përdoruesi është abonuar. Komisioni europian e ka konfirmuar këtë analizë në udhëzime dhe gjatë analizës së rasteve konkrete³. Telefonia fikse nuk e ka këtë cilësi të komunikimit në lëvizje dhe si e tillë ajo nuk mund ta zëvendësojë telefoninë celulare. Pra, ky lloj shërbimi nuk bën pjesë në tregun e telefonisë së lëvizshme, pasi nuk plotëson karakteristikën thelbësore të shërbimit celular të përmendur më lart⁴.
20. Shërbimi SMS nuk është pjesë e tregut përkatës, po për arsye të karakteristikave të ndryshme të këtij shërbimi me atë zanor. Shërbimi Telefonik (edhe ai Celular) ka si karakteristikë dalluese transmetimin e menjëhershëm të valëve zanore⁵ (zërit) nga pala thirrëse te ajo marrëse dhe anasjelltas, si dhe potencialisht është i pakufizuar në kohë⁶. Shërbimi SMS nuk e ka këtë veçori. Ky lloj shërbimi jep mundësi transmetimi të informacioneve të shkruara dhe të shkurtra (deri në 160 karaktere) dhe jo gjithmonë në koherencë për sa i përket momentit të dërgimit me atë të marrjes së këtij informacioni.
21. Tregu përkatës i produktit: konsiderohen shërbimet publike të telefonisë së lëvizshme të ofruara nga AMC dhe Vodafone Albania, që përfshijnë aksesin e përdoruesve në rrjet dhe thirrjet dalëse të ofruara nëpërmjet paketave me parapagim dhe me kontratë.
22. Tregu përkatës është analizuar edhe me nëndarjet e tij sipas shërbimeve që ofrojnë operatorët, pasi efekti i këtij tregu është më i ndjeshëm në nivelin e konkurrencës dhe i drejtpërdrejtë për ndikimin që ai jep mbi konsumatorin:
 - Parapagim;
 - Kontratë (privatë dhe biznes);
23. Tregu përkatës është analizuar duke marrë në konsideratë shërbimet e terminimit të thirrjeve telefonike për secilin operator celular AMC dhe Vodafone. Ky treg është analizuar kryesisht për çmimet dhe efektet që ato japin mbi tregun përkatës.

² Kusht paraprak për realizimin e këtij shërbimi është që përdoruesi i shërbimit celular të ketë një aparat telefonik celular dhe aksesin për këtë shërbim, që realizohet nëpërmjet një karte SIM të një operatori celular të instaluar në aparat.

³ Në rast se përdoruesi ka të përfshirë edhe shërbimin Roaming, ai mund ta përdorë telefonin e tij celular edhe në territoret e tjera, të mbuluara me shërbim nga operatorë të tjerë, me të cilët operatori i përdoruesit ka kontratë shërbimi Roaming.

⁴ “As regards the provision of mobile communications services, the Commission has found that, from a demand-side point of view, mobile telephony services and fixed telephony services constitute separate markets” (Commission guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community regulatory framework for electronic communications networks and services, OJ 2002/C 165/03, para. 66); çështja COMP/M.2574 Pirelli/Edizione/Olivetti/Telecom Italia, paragrafi 33: “Telefonia e Lëvizshme dallohet nga ajo fikse, pasi shërbimi i komunikimit (mobile) celular i lejon përdoruesit, përmes përdorimit të teknologjive Radiofonike, që të kënaqë kërkesat e tij të komunikimit në lëvizje, pavarësisht nga përdorimi i një aparati të përdoruesit të vendosur në një pikë terminale të rrjetit të telefonisë fikse.”

⁵ Valët zanore të palës thirrëse, konvertohen në valë elektromagnetike, të cilat transmetohen tek pala marrëse, ku ri konvertohen në valë zanore. I gjithë ky proces, kryhet me shpejtësinë e lëvizjes së valëve elektromagnetike ($\approx 300\,000$ km/sek) praktikisht në mënyrë të menjëhershme.

⁶ Kufizohet në kohë vetëm në shërbimin celular me parapagim, për aq kohë sa përdoruesi ka në dispozicion, nga sasia e shërbimit që ai ka blerë nëpërmjet kartës rimbushëse.

V.B. Tregu gjeografik

24. Treg gjeografik i shërbimit të telefonisë së lëvizshme të kompanive AMC dhe Vodafone është territori i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të licencave individuale, me të cilat operatorët AMC dhe Vodafone Albania operojnë, ato ofrojnë shërbimet e tyre, vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

VI. Vlerësimi i pozitës dominuese⁷

25. Në bazë të nenit 3, pika 5 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, me pozitë dominuese kuptohet “pozita e një ose me shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, përsa i takon ofertës dhe kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg si: konkurrentet, klientët ose konsumatorët.”
26. Në nenin 8 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, jepen kriteret e vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve. Disa nga këto kritere, si pjesët e tregut, barrierat në hyrje dhe konkurrenca potenciale, zënë një vend qëndror në analizën e pozitës dominuese.

VI.A.Pjesët e tregut përkatës të shoqërive AMC dhe Vodafone

27. Një nga kriteret kryesore, që përcaktojnë pozitën dominuese në treg është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun e produktit⁸. Pjesët e tregut llogariten duke u bazuar në numrin e abonentëve ose në të ardhurat e çdo ndërmarrjeje në treg.
28. Në bazë të vlerësimit të pjesëve të tregut të shoqërive AMC dhe Vodafone sipas kriterit të numrit mesatar të abonentëve dhe të ardhurave, rezulton se bazuar në numrin mesatar të abonentëve në vitin 2004, AMC sha zotëron përafërsisht 52 % dhe Vodafon 48 % të tregut dhe në vitin 2005. AMC sha 51 përqind dhe Vodafon sha 49 % të tregut⁹. Përsa i përket ndarjes së tregut sipas kriterit të të ardhurave nga shërbimet e thirjeve në vitin 2004, AMC dhe Vodafon zotërojnë përkatësisht 49 % dhe 51 %, dhe në vitin 2005 përkatësisht 47 % dhe 52 % të tregut¹⁰.
29. Nga ndarja e tregut në tërësi, rezulton se shoqëritë AMC dhe Vodafone gjatë periudhës objekt hetimi zotërojnë 100 përqind të tregut të telefonisë së lëvizshme.

⁷ Kjo dispozitë është e bazuar në të drejtën europiane, në veçanti në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë që lidhet me nenin 82 të Traktatit të BE-se: “... një pozite fuqie ekonomike që i jep mundësi një ndërmarrje të pengojë mbajtjen e një konkurrence efektive në tregun përkatës, duke e lejuar atë të silltë në mënyrë mjaft të pavarur përkundrejt konkurrentëve të saj dhe klientëve dhe së fundi përkundrejt konsumatorëve.”

⁸ Sipas të Drejtës së Konkurrencës të Bashkimit Evropian: zotërimi nga ndërmarrjet i pjesëve të konsiderueshme të tregut të produktit për një farë kohe, ka shumë të ngjarë që të jetë tregues i pozitës së tyre dominuese në treg, por vetëm ky tregues nuk mund ta provojë këtë pozitë. Rasti i vetëm, kur ky tregues konsiderohet i mjaftueshëm është kur ndërmarrjet zotërojnë 50% apo më shumë të tregut të produktit.

Ky vlerësim, konfirmohet edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në Luksemburg (GjED) në çështjen nr. 85/76, date 13.02.1979 Hofmann-La Roche, (paragrafët 39, 41): “Ekzistenca e Pozitës Dominuese mund të rrjedhë nga disa faktorë, të cilët, të marrë veç e veç, nuk janë domosdoshmërisht vendimarrës, por ndërmjet këtyre faktorëve ekzistenca e një pjese të lartë të tregut është shume e rëndësishme.

“... megjithëse madhësia e pjesëve të tregut ndryshon nga tregu në treg, me të vërtetë mund të thuhet që pjesë të mëdha të tregut përbejnë në vetvete, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, prove të ekzistencës së një pozite dominuese. Ky interpretim i dhënë nga gjykata shërbeu si bazë edhe për përcaktimin e përqindjes së mjaftueshme së pjesës së tregut të një ndërmarrjeje për vlerësimin e pozitës dominuese të saj vetëm mbi bazën e këtij kriteri. Konkretisht në çështjen AKZO shprehimisht të trajtuar prej po kësaj gjykate (GJED), thuhet: “Në rast të zotërimit të një pjese tregu prej të paktën 50%, Pozita Dominuese mund të prezumohet. Në këtë rast barra e provës do të kalojë mbi ndërmarrjen që zotëron mbi 50% të tregut, e cila duhet të japë argumente për mohimin e prezumimit (që nuk zotëron 50% të tregut – shënimi ynë)”

⁹ Burimi: Pasqyra “Ecuria e abonentëve të AMC në vite” dhe pasqyra “Numri i klientëve” Vodafone.

¹⁰ Burimi: Llogaritë vjetore, pasqyra e të ardhurave për AMC dhe Vodafone 2004 dhe 2005.

VI.B. Pengesat në hyrjen në treg (administrative, teknike dhe ekonomike)

30. Tregu i telefonisë së lëvizshme në Shqipëri është i rregulluar nga institucione publike¹¹. Institucioni i ngarkuar për rregullimin e tregut të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë është Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT).
31. Pengesat në hyrje janë faktorë të cilët i pengojnë operatorët e rinj të hyjnë në një treg të caktuar. Këto mund të jenë administrative, teknike dhe ekonomike

Barrierat administrative

32. Në Shqipëri, numri i licencave është kufizuar në bazë të akteve nënligjore dhe më konkretisht me Vendim të Këshillit të Ministrave (“Qeveria angazhohet të hapë sektorin e telekomunikacioneve për konkurrencë nëpërmjet lejimit të pjesëmarrjes së interesave private. Edhe me hapjen e plotë të tregut të telekomunikacioneve për konkurrencë, disa shërbime do të vazhdojnë të ekzistojnë në këtë kategori ku numri i licencave është i kufizuar, për shkak të burimeve të kufizuara natyrore siç janë frekuencat”¹²). Kjo shpreh mjaft qartë faktin se kemi të bëjmë me një treg ku ekzistojnë barrierat hyrëse administrative).

Barrierat teknike

33. Spektri i radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar,¹³ ndërkohë që plani kombëtar i radiofrekuencave ose ndryshimi i tij miratohet nga Këshilli i Ministrave. Për ushtrim normal të një veprimtarie teknike në këtë treg është e nevojshme që një shoqëri e licensuar në këtë treg të ketë në dispozicion mesatarisht 40-50 radiofrekuenca në bandën 900Mhz dhe rreth 80-100 radio frekuenca në bandën 1800 Mhz. Shqipërisë i janë lënë në dispozicion nga Rrjeti Europian i Telekomunikacionit rreth 174 radiofrekuenca në bandën 900 Mhz dhe rreth 384 në bandën 1800 Mhz.

Barrierat ekonomike

34. Operatorët për tu futur në tregun e telefonisë së lëvizshme, duhet të kryejnë investime të mëdha, si për blerjen e licensës, ashtu edhe për ndërtimin e rrjetit të tij të telefonisë celulare, që do të thotë se këto përbëjnë barrierat ekonomike për operatorët e rinj për të hyrë në treg.
35. Operatorët ekzistues, AMC dhe Vodafone, kanë krijuar avantazhe të konsiderueshme në tregun e telefonisë celulare. Ato kanë krijuar rrjetet e tyre, klientët përkatës (abonentët), eksperiencë në menaxhimin e tregut, emër nëpërmjet marketingut, si dhe fuqi të konsiderueshme ekonomike dhe financiare. Në këto kushte, operatorëve të rinj do tu duhet kohë dhe mjete monetare të konsiderueshme, për tu bërë pjesë efektive e këtij tregu. Numri i abonentëve potencialë të mbetur në treg është relativisht

¹¹ Barrierat ligjore ose rregullatore nuk bazohen në kushte ekonomike, por rezultojnë nga masa shtetërore legjislative, administrative ose të tjera, që kanë një efekt direkt mbi kushtet e hyrjes dhe/ose pozicionimin e operatorëve në tregun përkatës (Rekomandimi i Komisionit Europian i datës 11.02.2003 “Për produktin përkatës dhe tregun e shërbimeve në sektorin e komunikimeve elektronike”).

¹² Politika e Zhvillimit të Telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Vendimin nr 288, datë 18.06.1999 dhe i ndryshuar (1999, 2001, 2002, 2003)

¹³ Po aty, neni 69

i kufizuar. Për të siguruar një nivel konkurrues të pranueshëm, këta operatorë të rinj do të duhet t'i marrin përdoruesit e shërbimeve të tyre nga operatorët ekzistues, proces i vështirë për shkak të epërsive që kanë këta të fundit. Ky proces padyshim që përbën një barrierë të konsiderueshme për operatorët e rinj, që duan të futen në treg.

36. Avantazh për operatorët AMC dhe Vodafon përbën edhe fakti që operatori i tretë i licensuar në mars të vitit 2004, Eagle Mobile, nuk e ka ushtruar aktivitetin e tij gjatë periudhës objekt hetimi

VI.C Konkurrenca potenciale

37. Nga analiza e tregut të telefonisë së lëvizshme rezulton se, për periudhën 2004-2005, konkurrenca në tregun e telefonisë ka qenë e ulët. Kjo ka ardhur kryesisht nga mungesa e operatorëve të tjerë në treg, për shkak të barrierave të larta hyrëse. Eagle Mobile nuk ka ushtruar aktivitet gjatë periudhës objekt hetimi. Në këtë mënyrë kjo shoqëri nuk ka ushtruar ndonjë fuqi kundërvepruese ndaj shoqërive AMC dhe Vodafon, duke mos krijuar asnjë efekt në konkurrueshmërinë e tregut.
38. Qëndrueshmëria dhe rritja e normave të fitimit të operatorëve AMC dhe Vodafone, çojnë në konkluzionin që tregu nuk ka qenë mjaftueshëm konkurrues, sepse tregjet konkurrenciale karakterizohen nga ulja e normave të fitimit në kohë.

Tabela 1--Treguesit e fitimit për shoqërinë AMC për vitet 2003-2005¹⁴ (në përqindje)

| Treguesit e fitimit | 2004 | 2005 |
|----------------------|------|------|
| Norma e EBITDA | 57 | 56 |
| Norma e fitimit neto | 30.2 | 33.2 |

Tabela 2-- Treguesit e fitimit për shoqërinë Vodafone për vitet 2003-2005 (në përqindje)

| Treguesit e fitimit | 2004 | 2005 |
|----------------------|------|------|
| Norma e EBITDA | 51 | 55 |
| Norma e fitimit neto | 18.9 | 26.4 |

VI.D.Fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve

39. Kompanitë AMC dhe Vodafone janë dy ndërmarrje të mëdha jo vetëm në tregun e telefonisë së lëvizshme, por dhe në ekonominë shqiptare. Ato janë pjesë e grupeve ndërkombëtare të telekomunikacionit, Cosmote dhe Vodafone, të listuara në bursat ndërkombëtare.
40. AMC dhe Vodafone për periudhën e hetimit rezultojnë kompani me xhiron vjetore më të lartë në Shqipëri. Totali i xhiros së tyre për vitin 2004, prej 33 835 819 lekë, përbën rreth 4.45 % të Produktit të Brendshëm Bruto¹⁵.

¹⁴ Të dhënat marrë nga llogaritë vjetore të AMC dhe Vodafon dhe përpunuar nga ana jonë.(EBITDA është llogaritur duke zbritur nga të ardhurat të gjitha shpenzimet e kryera, para interesave, taksave dhe amortizimit).

¹⁵ PBB (v.2004)= 752 368 000 000 lekë, burimi: Raporti Statistikor i BSH-së, shkurt 2007

Tabela 3- Të ardhurat vjetore(në mijë lekë)

| KOMPANITE | 2004 | 2005 |
|-----------------------|------------|------------|
| Të ardhurat AMC | 16 829 067 | 18 319 973 |
| Të ardhurat Vodafone | 17 006 752 | 19 716 893 |
| Totali i të ardhurave | 33 835 819 | 38 036 866 |

41. Normat e fitimit, (shih tabela nr.2) kanë qenë të larta, të qëndrueshme dhe në rritje.
42. Këta tregues, por edhe tregues të tjerë, si numri i abonentëve, (ky numër ka ardhur në rritje të vazhdueshme, në fund të vitit 2005 ka arritur 1 530 867) përqindja e lartë e mbulimit të territorit dhe mbulimit të popullsisë me shërbime, evidentojnë fuqinë e konsiderueshme ekonomike dhe financiare të shoqërive AMC dhe Vodafone

VI.E. Fuqia kundërvepruese e blerësve

43. Konsumatorët në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri, nuk zotërojnë fuqi kundërvepruese për tu marrë në konsideratë.
44. Në ndarjen e tregut sipas shërbimeve rezultojnë se 97% janë abonentë të shërbimit me parapagim dhe 3% abonentë me kontratë (si për tregun në tërësi ashtu edhe për shoqëritë AMC dhe Vodafone në veçanti). Abonentët e shërbimit me parapagim janë përdorues të vegjël dhe nuk kanë mundësi negociuese, pjesa tjetër e abonentëve përbëjnë një numër të vogël (megjithatë pjesa më e madhe e këtyre të fundit janë persona fizikë).

Tabela 4- Përqindja e shërbimeve me parapagim dhe kontratë sipas numrit mesatar të secilit shërbim

| Emërtimi | 2004 | % | 2005 | % |
|-----------------------------------|----------------|------------|------------------|------------|
| Nr. mesatar abone. parap. AMC Vod | 1147239 | 97 | 1353428 | 97 |
| Nr. mesatar abon. kontr. AMC Vod | 32164 | 3 | 41292 | 3 |
| Totali | 1179403 | 100 | 1394719.5 | 100 |

45. Shoqëritë AMC dhe Vodafone¹⁶ për periudhën 2004 dhe 2005, kanë ofruar një numër të vogël programesh shërbimi dhe pa ndonjë ndryshim të ndjeshëm në çmimet e përdorimit të këtyre programeve (duke përjashtuar shërbimin me kontratë biznes, mundësia e zgjedhjes së të cilit është e kufizuar). Në këto kushte, mundësitë e konsumatorit për të zgjedhur janë të pakta dhe pa efekt.
46. Ndërrimi i llojit të shërbimit (nga shërbimi me kontratë në atë me parapagim dhe anasjelltas), si dhe ndërrimi i operatorit ka kosto¹⁷ për konsumatorin, që do të thotë që konsumatori për ndërmarrjen e një veprimi të tillë duhet të ketë interes ekonomik.
47. Mungesa e portabilitetit të numrave dhe informacioni i kufizuar, ul ndjeshmërinë e përdoruesit për të ndërruar operatorin.

¹⁶ Pasqyrat financiare të konsoliduara 2005 ... të saktësohet burimi

¹⁷ Në rastet e ndërrimit të llojit të shërbimit, konsumatori detyrohet të shpenzojë: për blerjen e një karte të re të aksesit të shërbimit (SIM), dhe për njoftimin e të njohurve për ndërrimin e numrit. Si dhe një kosto psikologjike të spostimit.


VI.F. Karakteristika të tjera të tregut

48. Produkti përkatës në tregun e telefonisë së lëvizshme është homogjen;
49. Kërkesa në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri ka qenë e qëndrueshme¹⁸.
50. Kosto në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri, është uniforme, prej teknologjisë gati të njëjtë të produktit të këtij tregu, por edhe për kushtet e përafërta që kanë shoqëritë AMC dhe Vodafone.
51. Nisur nga pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezultojnë se në mbështetje të nenit 8 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, **kompanitë AMC dhe Vodafone kanë pozitë dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme.**

VII. Sjellja e Ndërmarrjeve në Treg

52. Shoqëritë kanë aplikuar tarifa të përafërta, të qëndrueshme dhe pa fleksibilitet konkurrues, gjatë gjithë periudhës objekt hetimi (shihni grafiket¹⁹ në vijim).

Grafiku 1-Tarifat e AMC-se per periudhen 2004 dhe 2005




53. Tarifat e aplikuar nga AMC gjatë periudhës objekt hetimi kanë ndryshuar vetëm në Qershor 2004, ku ka pasur ulje vetëm për thirrjet brenda rrjetit për të tre llojet e shërbimeve dhe për thirrjet drejt rrjetit fiks për shërbimin me parapagim dhe atë me kontratë biznes). AMC në Qershor 2004 ka rritur të gjitha tarifat për thirrjet dalëse ndërkombëtare.

¹⁸ Rritimi i rritjes së kërkesës në tregun e telefonisë ka qenë mjaft i lartë, për shembull për vitet 2003, 2004, 2005 ai ka qenë përkatësisht: 29%, 15% dhe 21%, sipas numërit të abonentve.

¹⁹ Burimi: AMC Dosja Nr 1 e pyetësorit, pasqyrat “Tarifat e aplikuar nga AMC”, Vodafone “Dosja e tarifave”.


Grafiku 2-Tarifat e thirrjeve per Vodafone per periudhen 2004 dhe 2005



- 54. Vodafone, gjatë gjithë periudhës objekt hetimi, ka aplikuar tarifa të pandryshuara, sipas të dhënave të deklaruara nga kompanitë dhe të paraqitura në grafikun nr 2, të mësipërm.
- 55. Tarifat e aplikuara nga të dy operatorët janë të përafërta dhe përgjithsisht komplementare. Ndryshimet e këtyre tarifave, midis operatorëve, krijojnë simetri në tërësinë e shërbimeve të thirrjeve. Grafikët 3 dhe 4 si më poshtë, shprehin krahasimet e tarifave respektivisht për vitet objekt hetimi 2004 dhe 2005.


Grafiku 3

Krahasimi i tarifave per AMC dhe Vodafone te vitit 2004



Grafiku 4

Krahasimi i tarifave per AMC dhe Vodafon 2005



56. Të dyja shoqëritë AMC dhe Vodafone, nuk kanë zbatuar Vendimin Nr. 179, datë 07.05.2004 të ERT-së, me anë të të cilit ajo vendosi të rekomandojë tarifën e terminimit kombëtar për telefoninë e lëvizshme prej 22 lekë/minutë. Kjo do të thotë që tarifa e terminimit kombëtar në tregun e telefonisë së lëvizshme të ishte jo më i lartë se 22 lekë/minutë për vitin 2004 dhe jo më e lartë se 28 lekë/minutë për 2005. Komisioni i Konkurrencës çmon që ky çmim pasqyrore në atë kohë tarifën e një tregu me konkurrencë efektive.
57. Ulja e tarifave të terminimit me marrëveshje në nivelin 28 lekë/minutë në fund të vitit 2004 nuk ka ndikuar në uljen e tarifave të produktit përkatës për të dy kompanitë, AMC dhe Vodafon, gjatë periudhës objekt hetimi.
58. Të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifë terminimi kombëtar mbi dy herë më të lartë, krahasimisht me tarifën mesatare të terminimit të vendeve të rajonit.

Tabela 5- Tarifa e terminimit te operatoreve shqiptare dhe tarifate terminimit te vendeve te rajonit në 31 Dhjetor 2004²⁰, Eurocent./minutë


| Tarifë terminimi | Shqiperi | Bullgari | Kroaci | Rumani | Mali Zi | Serbi | Maqedoni | Turqi | Mes. pa Shqip |
|------------------|----------|----------|--------|--------|---------|-------|----------|-------|---------------|
| | 23 | 19.1 | 8.8 | 7.3 | 16.5 | 2.5 | 11.8 | 8.4 | 10.6 |

59. Te dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifa për shërbimin me parapagim mesatarisht mbi dy herë më të larta se mesatarja respektive e vendeve të rajonit. Ky fakt shprehet në grafikun nr. 5 të paraqitur më poshtë:

²⁰ Marrë Dokumenti i Analizës së Telefonisë së Lëvizshme të ERT-së. fq. 16, Burimi: Cullen International Country Comparative Report, August 29, 2005.

Grafiku 5

Tarifat e kartes SIM me parapagim per vendet e rajonit ne Euro (2005)



60. Grafiku i mësipërm tregon se tarifa e aplikuar nga operatorët AMC dhe Vodafone është afërsisht 2.4 herë më e lartë se mesatarja e rajonit, dhe koha e bisedës bonus është afërsisht 2.5 herë më e ulët se mesatarja e rajonit.
61. Te dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifa për shërbimin me kartë për thirrjet brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit, më të larta se sa mesatarja e rajonit. Ky fakt evidentohet nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr 7 dhe grafiku nr 6

Tabela 6 - Krahasimi i tarifave të shërbimit me kartë për kompanitë e rajonit për thirrjet brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit, Nëntor 2005 (ne euro)²¹


| Lloji i shërbimit | KOMPANITE | | | | | | | | |
|-------------------|-----------|----------|----------|---------|---------|--------|----------|-----------|---------------|
| | AMC | Vodafon | Globul | Cosmote | Mobitel | Vipnet | Vala 900 | Promonte | pa Shqipërinë |
| | Shqipëri | Shqipëri | Bullgari | Rumani | Serbi | Kroaci | Kosove | Mali i Zi | Tarifa mesat |
| Brenda rrjetit | 0.306 | 0.367 | 0.19 | 0.16 | 0.124 | 0.14 | 0.16 | 0.096 | 0.145 |
| Jashtë rrjetit | 0.408 | 0.441 | 0.19 | 0.16 | 0.147 | 0.315 | 0.16 | 0.115 | 0.181 |

²¹ Burimi: Tarifët e thirrjeve të operatorëve të rajonit janë marrë nga dosja nr. 1 e pyetësorit të AMC-së, nga pasqyra tarifave të fqinjëve. Kursi i këmbimit të përdorur është ai i nëntorit 2005

| | | |
|----------|---------------|----------------------|
| Albania | Leke / EURO | 1 Euro = 122.46 |
| Bulgaria | BGN / EURO | 1 Euro = 1.948 Lev |
| Serbia | Dinnar / EURO | 1 Euro = 84.96 Dinar |
| FYROM | MKD / EURO | 1 Euro = 60.23 Denar |
| CROATIA | HRK / EURO | 1 Euro = 7.4 Hrk |

Grafiku 6

Krahasimi i tarifave te shërbimit me karte per kompanite e rajonit Nentor 2005



VIII. Abuzimi i AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a me Pozitën e tyre Dominuese²²

62. Bazuar në Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 9, pika 1 “Ndalohet çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese në treg” dhe 2, germa a ”Mund të përbëjnë abuzim veçanërisht vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta blerjeje ose shitjeje, ose e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit”
63. Sipas nenit neni 9, pika 2, gërma a, një ndër format kryesore të abuzimit me pozitën dominuese është zbatimi i çmimeve të padrejta prej tyre (Unfair Pricing ose Excessive Prices)²³. Çmimi i praktikuar është i padrejtë kur ai është shumë më i lartë se çdo të ishte në një treg konkurrues. Për të vlerësuar karakterin e padrejtë të çmimit, në radhë të parë mund të krahasohet niveli i çmimit me vlerën ekonomike të produktit, ose e thënë ndryshe me koston e tij²⁴. Në radhë të dytë, dhe në pamundësi për të përcaktuar

²² Komisioni i Konkurrencës konstaton që ndërmarrjet që janë në pozitë dominuese nuk mund të kenë të njëjtën shkallë lirie veprimesh (qoftë edhe për të mbrojtur interesat e tyre) kur këto çojnë në forcimin e pozitës së tyre dominuese dhe abuzimin me të. Në lidhje me këtë pikë për të qartësuar se çfarë kihet parasysh më lart po jepet tekstualisht një sentence nga Çështja Deutsche Grammophon GmbH v Metrosh-Grossmarkte : “Ashtu siç del dhe nga sentenca e Gjykatës, ndryshimi i çmimit mund të jetë një tregues vendimtar për një abuzim me pozitën dominuese sipas nenit 86 të Traktatit të Bashkimit Ekonomik Europian, nëse ai është i madh dhe i vendosur pa motiv objektiv”. Po kështu dhe në rastin Sirena v Eda-s tekstualisht shprehet : “Atë që kërkon shfrytëzimi abuziv i një pozicioni dominues, këtë abuzim nuk e tregon domosdoshmërisht vetëm çmimi i lartë i prodhimit, por megjithatë ai mund të jetë një tregues vendimtar, kur nuk është i përligjur dhe tepër i lartë, si dhe asnjans.”

²³ Në çështjen General Motors, 1975, par. 12, Gjykata e Drejtësisë së KE-së konsideron që : «Abuzimi mund të konsistojë, në veçanti, në vjeljen e një çmimi të ekzagjeruar në raport me vlerën ekonomike të shërbimit të ofruar»; Gjykata e Drejtësisë ka trajtuar gjithashtu në çështjen United Brands, 1978, par. 250 si abuzim«[...] praktikën e një çmimi të ekzagjeruar pa lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të shërbimit të ofruar. »

²⁴ Në këtë rast duhet parë «nëse ekziston një diferencë tepër e lartë excessive ndërmjet koston dhe çmimit të kërkuar, dhe nëse kjo vërtetohet, të ekzaminohet nëse ka vendosje çmimi të padrejtë qoftë në nivelin absolut, qoftë duke e krahasuar me produkte konkurren- te» (United Brands, ECJ 1978, paragrafi 252).

koston e prodhimit, niveli i çmimit në treg, si dhe norma e fitimit, mund të krahasohet me nivelin e çmimit ose të fitimit të produkteve të krahasueshme apo me çmimin dhe normën e fitimit të të njëjtëve produkte në tregje gjeografike të ndryshme²⁵. Sipas rastit dhe informacioneve në dispozicion, mund të përdoren dhe metoda të tjera²⁶.

64. Për vërtetimin e abuzimit do të duhet të kalohet në tre teste. Provimi i njërit prej tyre, ose dhe me tepër, do të provonte abuzimin me pozitën dominuese²⁷.

VIII.A Vendosja e çmimeve të larta pa lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit

65. Çmimet e shërbimeve të ofruara nga këto shoqëri, nuk kanë lidhje të arsyeshme me kostot përbërëse të tyre. “Vlera ekonomike mund të marrë si orientim koston e produktit, çmimin e mallrave të tjerë të ngjashëm, ose çmimin e një prodhimi të ngjashëm në një territor tjetër”²⁸.
66. Po të zbatonin shoqëritë tarifën e terminimit kombëtar prej 22 lekë/minutë të dhënë në Vendimin Nr.179, datë 07.05.2004 të ERT, i cili është konsideruar si banchmark për atë periudhë, si dhe tarifën e terminimit kombëtar 28 lekë/minutë si benchmark për vitin 2005, atëhere tarifave të terminimit fundor kombëtar në llogjikën e formimit të tarifave të pakicës, duhet të reflektonin të paktën me një minimum ndryshimi, fakt i cili nuk është evidentuar gjatë periudhës nën hetim.
67. Po të merret në konsideratë që tarifa e aplikuar e terminimit ndërkombëtar gjatë periudhës në hetim ka qenë më e ulët se kostoja e tij, atëhere humbja vjetore për këtë shkak, është e barabartë me trafikun vjetor hyrës ndërkombëtar shumëzuar me humbjen për minutë (diferenca midis koston dhe çmimit të terminimit ndërkombëtar). Nëse ky aktivitet nuk do të ishte me humbje, atëhere fitimi i dy kompanive celulare do të ishte akoma më i madh.

VIII.B Sigurimi i përfitimeve tregtare, të cilat nuk do të siguroheshin në një treg të prezumuar konkurrues

68. Për këtë test mund të vlerësohet niveli i lartë dhe në rritje i normave të EBITDA-s dhe fitimit për të dyja shoqëritë. Në tregje me konkurrence normale normat e fitimit vijnë përgjithësisht në ulje. Ky fakt është shprehur në tabelën nr 1 “Treguesit e fitimit për shoqërinë AMC për vitet 2004 dhe 2005” dhe në tabelën nr 2 “Treguesit e fitimit për shoqërinë Vodafon për vitet 2004 dhe 2005”
69. Treguesi i të Ardhurës Mesatare për Përdorues për Minutë të Përdorur nga Abonentët (ARPU/MOU) e të dy shoqërive kanë vlerat më të larta të krahasuara me vende të Evropës Perendimore. Ky fakt, i paraqitur edhe në tabelën nr 7, evidenton se tarifave të aplikuar për abonentët vëndas janë të larta.

²⁵ Në çështjen SACEM, çështje të bashkuara 110/88, 241/88 dhe 242/88, 1989, në veçanti në paragrafin 25, Gjykata e Drejtësisë ka konsideruar që : «[...] kur një ndërmarrje në pozitë dominuese vendos tarifa që janë shumë më të larta se tarifave që praktikohen në vendet e tjera anëtare, dhe kur krahasimi kryhen në një bazë homogjene, kjo diferencë duhet konsideruar si shenjë që tregon abuzim të pozitës dominuese.»

²⁶ Gjykata e Drejtësisë së KE ka qenë gjithmonë e hapur për metodën e ndjekur për përcaktimin e çmimit të padrejtë. Në çështjen United Brands, 1978, par. 253, ajo konsideron : «mund të konceptohen metoda të tjera – dhe doktrina ekonomike ka konceptuar disa nga këto – për të nxjerrë kriteret e përcaktimit të çmimit të padrejtë të një produkti.»

²⁷ Çështja British Leyland v Commission ECR nr 311/84, 3283 (1986)

²⁸ Bellamy&Child (2001) “European Community Law of Competition”.

Tabela 7-Vlera e ARPU (Euro në vit) dhe MOU për Vodafone Group 2004²⁹

| Shërbimet | Shqipëri | Gjermani | Itali | Greqi | Spanjë | Irlandë |
|--------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Parapagim | 171 | 121 | 306 | 211 | 179 | 370 |
| Kontratë | 2458 | 482 | 927 | 781 | 687 | 1186 |
| Mesatare | 241 | 303 | 360 | 398 | 408 | 602 |
| Parapagim % | 97 | 52 | 92 | 66 | 54 | 72 |
| Min/përdorues | 202 | 227 | 401 | 442 | 472 | 635 |
| ARPU/MOU mesatare | 1.19 | 1.33 | 0.90 | 0.90 | 0.86 | 0.95 |

VIII.C Krahasimi i tarifave me tregje të tjera gjeografike³⁰

70. Komisioni i Konkurrencës konstaton se, në mungesë të një modeli të kostos të detajuar të shërbimeve, mund të përdoret alternativa krahasuese (benchmark³¹-u) të tarifës së shërbimit me ato të shërbimeve respektive, ose të ngjashme në rajon.
71. Sipas “Cullen Report 2 – Country Comparative Report (2006)“ Shqipëria përfaqëson një përjashtim në lidhje me çmimet, që e vendos atë midis vendeve me çmime më të larta të EU-së³².
72. Në të njëjtin raport paraqitet krahasimi i tarifave mesatare të shportave³³ të shërbimeve të telefonisë të lëvizshme midis vendeve të rajonit dhe me tarifën³⁴ e vendeve europiane. Sikurse paraqesin edhe grafikët 7³⁵ a, b, dhe c, në tre grupimet, tarifën mesatare të shërbimeve celulare të aplikuara në Shqipëri, janë më të lartat e rajonit dhe për përdoruesit e mesëm dhe të mëdhenj të shërbimit celular janë të niveleve të tarifave më të larta në Europë (shih grafikun 7 b dhe c). Në këtë raport nënvizohet se: “..Shqipëria ka tarifën që janë afër më të lartave që gjenden në vendet e Komunitetit Europian.”³⁶
73. Të dhënat e paraqitura në këto grafikë konfirmojnë që shoqëritë objekt hetimi kanë aplikuar tarifa më të larta se vendet e rajonit me nivel të Produktit të Brendshëm Bruto (GDP) dhe të ardhura për frymë të krahasueshme me Shqipërinë (p.sh Maqedonia).

²⁹ Marrë nga Dokumenti i Analizës Tregut të ERT-së, fq 38. Të dhënat nga Vodafone Group. Treguesi i ARPU/MOU mesatare është llogaritur nga Autoriteti i Konkurrencës.

³⁰ Komisioni Federal Zviceran i Konkurrencës ndërmori një hetim në tregun e Telefonisë së Lëvizshme kundrejt 3 shoqërive Swisscom, Orange dhe Sunrise, të cilat kishin pozitë dominuese. Komisioni i Konkurrencës përdori si një nga metodat kryesore të hetimit atë të krahasimit me vende të tjera të BE-së (Benchmarking). Komisioni Zviceran i Konkurrencës u detyrua ta përdorë këtë metode në pamundësi të analizës së çmimit të lartë (excessive), pasi shoqëria Swisscom refuzoi disa herë t’ja dërgonte analizën lidhëse mes kosos dhe çmimit të shërbimeve të saja të ofruar në treg. Krahasimi u fokusua në dy vende me karakteristika të ngjashme me Zvicrën në dy aspekte. Kështu u mor për bazë Suedia si vendi i ngjashëm duke parë kriterin e GDP-së. Ndërsa për kriterin e territorit gjeografik dhe të ndërtimit të rrjetit u mor për bazë Austria. Gjatë hetimit rezultoi se 3 shoqëritë e sipërpërmendura jo vetëm që ishin në pozitë dominuese, por edhe kishin abuzuar me këtë pozitë dominuese duke hedhur në treg shërbime me çmime tejet të larta (excessive prices) dhe u vendos ndëshkimi me gjobë i këtyre shoqërive.

³¹ Vendimi i Komisionit Europian i 25 Korrik 2001 në lidhje me procedimin sipas nenit 82 të traktatit (COMP/C-1/36.915-Deuche Post AG-Interception of cross-border mail), paragrafi 159. “Në lidhje me çështjen e Gjykatës së Drejtësisë, drejtësia e një çmimi të caktuar mund të testohet duke e krahasuar këtë çmim me vlerën ekonomike të mirës ose shërbimit të ofruar. Një çmim i cili është vendosur në një nivel i cili duket jo i arsyeshëm në lidhje me vlerën ekonomike të shërbimit të ofruar, duhet të cilësohet si eksziv në vetvete përdërisa ka efektet e shfrytëzimit të padrejtë të konsumatorëve. Në një treg i cili është i hapur për konkurrencën testi normal që do të aplikohet do të ishte krahasimi i çmimit të operatorit dominues me çmimet e konkurrentëve të tjerë. Për shkak të ekzistencës së DPAG’s si monopol i gjerë, një krahasim i tillë çmimi nuk është i mundur në rastin konkret. Për më tepër DPAG ka prezantuar së fundmi një sistem transparent, ndërkombëtar të llogaritjes së kosos dhe nuk ekziston asnjë e dhënë e besueshme për periudhën përkatëse të këtij rasti. Në vijimshëm Komisioni nuk është në gjendje të bëjë një analizë të detajuar kostoje të kosos mesatare të DPAG për shërbimet në fjalë përgjatë kësaj periudhe. Për këtë arsye duhet të përdoret alternativa e benchmarkut.

³² Albania represents the exception with prices that would rank among the highest in the EU Raporti Cullen Report 2 – Country Comparative Report June 26, 2006, fq. 14.


³³ Tarifën janë mesatarizuar duke grupuar përdoruesit sipas tre grupeve: a) shporta e përdoruesve të vegjël (pra që përdorin më pak telefonion celular) b) shporta e përdoruesve të mesëm dhe c) shporta e përdoruesve të mëdhenj.

³⁴ Tarifën mesatare për vendet europiane janë paraqitur të ndara në tre grupe, minimalet, maksimalet dhe vlerat mesatare të gjithë Europes.


³⁵ Cullen Report 2 – Country Comparative Report June 26, 2006 faqe 162, 163 figura 40,41.42.

³⁶ The figures suggest that the prices for the low usage basket compare favourably with those of the EU. Tariffs for all countries and geographic units except Albania are below the EU median. For the medium and high usage baskets the tariffs in South East Europe appear to be relatively higher when comparing with the EU. Albania has tariffs which are close to the highest found in the EU and also Turkey has tariffs above the EU median. Fq 162. Cullen Report 2 – Country Comparative Report June 26, 2006 (perk. Shifrat tregojnë se çmimet e shportave të përdoruesve të vegjël janë konkurrese me ato të BE.. Tarifën e të gjitha vendeve dhe zonave gjeografike, duke përjashtuar Shqipërinë, janë më të ulëta se mesatarja e BE-së. Tarifën e përdoruesve të mesëm dhe të lartë në Europën Juglindore duket se janë relativisht të larta kur i krahasojmë me ato të BE-së. Shqipëria ka tarifa të cilat i afrohen vlerave më të larta në BE. Edhe Turqia ka tarifa të cilat i afrohen mesatares së BE-së. Fq 162. Raporti i “Cullen” 2 – Raporti krahasues i vendit 26 Qershor 2006. *).


Grafiku 7 (a) Tarifat mesatare të përdoruesve të vegjël të telefonisë së lëvizshme sipas vendeve të rajonit dhe krahasuar me tarifatat e vendeve europiane për vitin 2005



Grafiku 7 (b) Tarifatat mesatare të përdoruesve të mesëm të telefonisë së lëvizshme sipas vendeve të rajonit dhe krahasuar me tarifatat e vendeve europiane për vitin 2005



Grafiku 7 (c) Tarifatat mesatare të përdoruesve të mëdhenj të telefonisë së lëvizshme sipas vendeve të rajonit dhe krahasuar me tarifatat e vendeve europiane për vitin 2005



PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d; nenet 8, 9,; nenin 74, germa a; neni 75 dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Shoqëritë AMC sha dhe Vodafone sha kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun të telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës objekt hetimi (2004, 2005).
2. Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, shoqëria Albania Mobile Communication sh.a. (AMC) gjobitet me 2 % te xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 211 552 000 lekë.
3. Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, shoqëria Vodafone Albania sh.a. (Vodafone) gjobitet me 2 % te xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 242 633 000 lekë.
4. Ngarkohet Policia Tatimore për vjeljen e gjobave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot më 09.11.2007

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

Nr. 60 Datë 12.11.2007

Për Hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Energjisë

Në mbështetje të nenit 24, shkronja d, nenit 26 dhe nenit 41 të Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës pasi mori në shqyrtim informacionet nga monitorimet e tregut të energjisë të përgatitur nga Sekretariati i Autoritet të Konkurrencës, në lidhje me kufizimet apo shtrembërimet e mundshme të konkurrencës në këtë treg:

K O N S T A T O I:

Tregu i energjisë në Shqipëri është një treg shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë kombëtare si dhe në një fazë ndryshimesh. .

Një konkurrencë efektive në këtë treg do të kishte efekte pozitive në rritjen e eficensës së burimeve të energjisë, shpërndarjes dhe konsumit pasi konkurrenca do të minimizonte kostot dhe do të rriste investimet në burime më eficente, do të rriste transparencën e veprimit të aktorëve të tregut. Për më tepër, rritja e nivelit të konkurrueshmërisë në këtë treg do të përmirësonte cilësinë e jetës të konsumatorëve shqiptar.

Nga monitorimet e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës të zhvilluar në kohë të ndryshme për disa nëntregje rezulton se ka shenja të kufizimit dhe të shtrembërimit të konkurrencës në këtë treg.

Gjithashtu, ka një shqetësim të vazhdueshëm dhe në rritje të konsumatorit, opinionit dhe institucioneve publike për fenomenet që vihen re, të cilat shprehin kufizime apo shtrembërimet të mundshme të sjelljes konkurruese të ndërmarrjeve që veprojnë në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 24, shkronja d dhe nenit 41 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës:

V E N D O S I:

1. Hapjen e hetimit të përgjithshëm në tregun e energjisë dhe nëntregjet e tij: karburantet; gazit të lëngshëm; dhe energjisë elektrike për të vërtetuar nëse konkurrenca në këtë treg kufizohet apo shtrembërohet.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës, ndjekjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm dhe përgatitjen e Raportit Përfundimtar për Hetimin e Përgjithshëm në tregun e energjisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar(_____)
Anëtar(_____)
Anëtar**Lindita Milo (Lati)**

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

Nr.61. datë 21.11.2007

“Për Disa Rekomandime për Tregun e Telefonisë së Lëvizshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09/11 /2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Rekomandime ndaj institucioneve publike në lidhje me Tregun e Telefonisë së Lëvizshme.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa f dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit të Grupit të Punës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme, Pretendimeve të palëve, në formën e shkruar dhe në Seancat Dëgjimore të datave 07.06.2007 me AMC-sha dhe 13.06.2007 me Vodafone Albania;

VËREN SE:

I. Fusha e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

1. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës zbatohet për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg dhe që e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 2 i Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës). AMC dhe Vodafone ofrojnë shërbime të telefonisë së lëvizshme në territorin e Shqipërisë dhe konsiderohen si ndërmarrje në bazë të nenit 3 pika 1 të këtij ligji. Si rrjedhim, veprimtaria e këtyre dy ndërmarrjeve përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.